

VENDIM
Nr.6, datë 9.4.2020

PËR DETAJIMIN E AKTIVITETEVE SIPAS NOMENKLATURËS SË
AKTIVITETEVE EKONOMIKE

Në mbështetje të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, dhe në vijim të marrjes së masave për përballimin e epidemisë të shkaktuar nga COVID-19, Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, i mbledhur sot në datën 9.4.2020,

VENDOSI:

1. Autorizimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për kryerjen e detajimit të aktiviteteve të përcaktuara në tabelën bashkëlidhur urdhrin nr.193, datë 20.3.2020, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të cilat detajohen sipas nomenklaturës së aktiviteteve ekonomike dhe miratohen sipas listës bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Aktivitetet e lejuara, sipas tabelës bashkëlidhur urdhrin nr.193, datë 20.3.2020, e ushtrojnë aktivitetin e tyre vetëm sipas udhëzimeve të miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik, për mospërhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

3. Ngarkohen ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOMITETIT NDËRMINTOR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINTËR
Edi Rama